

Përfitimet nga higjena e mjeljes

Përgatitur dhe përpunuar nga Bianca Duro – Austria Praemix shpk



Foto: <https://www.stallbedarf24.de/ratgeber/kuehe-richtig-melken-das-solltest-du-wissen/>

Higjena e mjeljes

Për të prodhuar qumësht me cilësi maksimale është e domosdoshme që procesi i mjeljes të kryhet në kushte optimale higjene. Veçanërisht fermat që kanë probleme me numër të lartë të qelizave somatike dhe ngarkesë të lartë mikrobike duhet t'i kushtojnë rëndësi higjenës gjatë procesit të mjeljes.

Ruajtja e pastërtisë së gjirit ndërmjet mjeljeve gjatë ditës, garantimi i shtretërve dhe koridoreve të thata, rezulton në më pak punë për pastrimin e gjirit dhe gjithashtu mban të ulët ngarkesën

mikrobike në stallë. Përgatitja optimale e lopës për procesin e mjeljes arrihet vetëm nëpërmjet stimulimit të mjaftueshëm dhe një ambjenti rrethues të qetë dhe pa stres në stallë.

Para çdo mjeljeje duhet të kontrollohet niveli i vakumit, sepse mungesa e këtij kontrollit ndikon negativisht në funksionimin e impjantit të mjeljes.

Testi para mjeljes

Para çdo mjeljeje duhet të bëhet prova e para-mjeljes për të larguar mikrobet e pranishme në kanalën e qumështit dhe për të evituar përzjerjen e tyre me qumështin që rrjedh nga gjëndra e qumështit. Përveç kësaj, testi para mjeljes shërben për vlerësimin e shëndetit të gjirit. Qumështi me konsistencë të ndryshuar (strukturë ujore, përzjerje gjaku apo i flokëzuar) nuk duhet të furnizohet në fabrikë dhe sinjalizon shenja të problemeve me shëndetin e gjirit.

Testi para mjeljes duhet të kryhet gjithmonë në një enë të zezë. Duke qënë se në rastin e inflamacioneve subklinike ndryshimet në përbërjen e qumështit në dukje janë minimale, shpesh herë nuk konstatohen në filtër ose gjatë provës së para-mjeljes. Në këto raste është e domosdoshme të merren masa të menjëhershme për trajtimin e kësaj pjese të gjirit (pasi është marrë prova e qumështit për të përcaktuar mikrobin dhe rezistencën e tij) si dhe të ndërmerret pastrimi dhe dizinfektimi i aparatit mjelës dhe duarve të mjelësit.

Pastrimi i gjirit

Pastrimi i gjirit është procesi kryesor para mjeljes. Pastrimi i gjirit bëhet pas marrjes së provës për të mënjeluar përzjerjen e qumështit nga gjëndra me qumështin e kontaminuar në kanalën e qumështit. Në praktikë shpesh ndodh që pastrimi kufizohet vetëm në pastrimin e gjirit, por jo të fillimit të kanali të tij. Kjo shkakton depërtimin e mikrobeve patogjene të mastitit në gjatë procesit të mjeljes. Shpesh herë mjafton pastrimi i thatë me peceta, të cilat duhet të lahen pas çdo përdorimi. Në rastet e ndotjes masive të gjirit është e nevojshme larja e tij me dush.


Pas kësaj është e domosdoshme tharja totale e gjirit për të evituar depërtimin e baktereve patogjene të mastitis në kanalën e qumështit nëpërmjet kapilarëve. Përveç kësaj, prania e lagështirës në gjatë ul intensitetin e mjeljes në fazën përfundimtare të procesit të mjeljes.

Ndalohet përdorimi i së njëjtës pecetë për disa lopë, pasi ekziston rreziku i përhapjes së mikrobeve dhe baktereve patogjene të mastitit. Në fermat me probleme mastiti dhe ngarkesë të lartë të qelizave somatike rekomandohet përdorimi i dezinfektantëve për pastrimin e thithave si

dhe dizinfektimi i rregullt i duarve të mjelësit (akoma më mirë aplikimi i dorezave njëpërdorimshme).

Masazhimi i gjirit

Nëpërmjet stimulimit mekanik të gjirit (në mënyrë manuale apo me anë të aparatit), veçanërisht në zonën e thithave, iniciohet prodhimi i hormonit *Oxytocin* dhe stimulohet gadishmëria e organizimit të lopës për procesin e mjeljes. Kjo sjell qarkullimin e qumështit, presion të lartë të qumështit gjatë mjeljes, shkurtim të kohës së mjeljes dhe reduktimin të kohës me intensitet të ulët mjeljeje.



Fiksimi jo i saktë i aparatit mjelës shkakton rritje të sasisë së qumështit të mbetur në gji dhe si pasojë shtimin e mikrobeve të mastitit. Faktorë të tjerë, si faktor akustik (pompa e vakumit) ose faktor optik (prania e personave të tjerë në stacionin e mjeljes), mund të shkaktojnë mosprodhimin e hormonit *Oxytocin* ose rrjedhje të qumështit. Aparati i mjeljes duhet të vendoset brenda 90 sekondave pas fillimit të stimulimit të gjirit. Për të shmangur vakumet në aparatin mjelës, duhet të kemi parasysh që gjatë vendosjes së gypave të mos ketë depërtim të ajrit. Nga luhatjet e vakumit është e mundur që qumështi me përmbajtje mikrobike në depozitën grumbulluese të qumështit të mbërrijë në gotat e mjeljes dhe si pasojë në cisternën e thithave.

Mjelja

Aparati mjelës duhet të pozicionohet në mënyrë optimale në gji, kjo do të thotë që gotat e mjeljes të vendosen direkt poshtë thithave dhe tubacionet nuk duhet të jenë të përdredhura. Shkëputja e gotave të mjeljes si pasojë e luhatjeve të vakumit, mund të përforcojë depërtimin e shkatarëve të mastitit në gji. Pas fillimit të rrjedhjes së qumështit duhet të kontrollohet me anë të prekjes niveli i zbrasjes së gjirit nga qumështi, kështu mund të konstatohet prania e një mastiti të mundshëm. Provat me vendosjen e aparatit mjelës duhet të evitohet, pasi ato mund të dëmtojnë indin e gjirit.

Pas heqjes së aparatit mjelës, bëhet kontrolli i gjirit. Prania e lagështirës në thitha tregon probleme të rrjedhjes së qumështit, edemat në formë unaze në bazamentin e thithave tregojnë një zhvendosje të aparatit mjelës. Deformimi i kanalit të mjeljes dhe shfaqja e hiperkeratozës shkaktohen nga ngarkesat mekanike të indit të kanalit mjelës.

Dezinfektimi i thithave

Pasi kanali i qumështit zgjerohet gjatë mjeljes dhe mbyllet përsëri pas 20-30 minutash, duhet që gjatë kësaj faze të evitohet depërtimi i mikrobeve në gji me anë të dezinfektimit të thithave. Dezinfektimi i thithave realizohet nëpërmjet zhytjes në gota me dezinfektant ose duke i spërkatur me spray. Ky proces duhet të kryhet menjëherë pas mjeljes, për të arritur menjanimin dhe ngordhjen e menjëhershme të mikrobeve të mastitit. Me anë të procesit të zhytjes reduktohet ndjeshëm niveli i *Staphylococcus aureus* dhe *Streptococcus agalactiae* dhe prania e lartë e yndyrave në solucionin dezinfektues ka një efekt zbutës tek thithat. Aplikimi i gotave njëpërdorimshme mënjanon transmetimin e bakteve patogjene të mastitit nga një lopë tek tjetra. Gjatë spërkatjes është i nevojshëm më shumë solucion dezinfektues dhe ekziston rreziku që jo i gjithë gjiri të jetë i dezinfektuar.

Dezinfektimi i enëve

Në fermat që përballen me problemin e mastitit, transmetimi i mikrobeve nëpërmjet aparateve mjelëse, kryesisht nëpërmjet gominës së aparatit luan një rol të rëndësishëm. Prandaj është e rëndësishme të bëhet dezinfektimi i aparatit mjelës para se ato të vendosen në lopën tjetër. Dezinfektimi mund të bëhet me solucion me tretësirë acide (PES). Kryerja e dezinfektimeve të ndërmjetme varet nga lloji i aparatit mjelës (zhytja me dorë e enëve të aparatit, spërkatja e gominës së aparatit ose dezinfektim i programuar). Në asnjë mënyrë nuk duhet të kalojë lëngu dezinfektues nga aparati mjelës në qumësht.

Mirëmbajtja e apartit mjelëse

Lopa milet minimalisht dy herë në ditë, prandaj një aparat mjelës që funksionon siç duhet, pa probleme, është një kriter themelor për mjeljen.

Para çdo mjeljeje duhet të kontrollohet vakumi i mjeljes. Sipas një plani të caktuar, duhet të bëhet rregullisht pastrim i filtrave të ajrit, i valvulës, duhet të ndryshohen gominat e aparatit mjelës dhe të kryhet një testim teknik i aparatit.

Dezinfektimi dhe përkujdesi ndaj thithave me PROACTIVE™

Përdorimi i një produkti, të licencuar për ferma, për të mjekuar mastitin mundëson luftimin e mikrobeve, të cilat depërtojnë në gji gjatë kohës së mjeljes. Teknologjia e patentuar mundëson rigjenerimin e jodit, kjo do të thotë që jodi i konsumuar rigjenerohet dhe kthehet në jod efektiv. Ky është një kriter për një mbrojtje afatgjatë kundër mikrobeve patogjene. PROACTIVE™ është një dezinfektant i gatshëm për thithat me efekt të dyfishtë – kujdesin ndaj lëkurës dhe dezinfektimin e gjirit- dhe aplikohet menjëherë pas mjeljes, gjatë procesit të zhytjes ose spërkatjes.

ACT është bartës jodi kosmetik i patentuar dhe mundëson depërtimin e solucionit në pore. Tek ACT, ndryshe nga përbërësit e tjerë për kujdesin ndaj lëkurës, një sasi e madhe e jodit mund të përdoret për dezinfektim.